



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i komunes



Nr. 02-060191-37798 dt. 03/09 /2026

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34,37 të Statutit të Komunës së Drenasit, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 Për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 6, me kërkesë të Kryetarit të Komunës përmes Email-it. Kuvendi i Komunës me dt. 09.09.2026 (ditë e mërkurë) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Thërret

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Rrezikimi i shëndetit publik, në veçanti në shkolla, si pasojë e mungesës së tejskajshme dhe alarmante të furnizimit me ujë të pijshëm, si rezultat i mosriparimit të pompave në Bivolak të Vushtrisë nga ana e KRU “Prishtina”, mosfunksionalizimit të burimeve sekondare të ujit në territorin e Komunës së Drenasit (Krajkovë, Gjurgjicë, Arllat, Kishnarekë, Baicë, Sankovc etj.), si dhe mostrajtimin të investimeve të Komunës nga ana e KRU “Prishtina” për ujin e pijes në fshatrat e Komunës së Drenasit.

Me qëllim të qellim të informimit të qytetarëve për çështjen e furnizimit me ujë, kundërshtimit të gjendjes së renduar, rrezikimi i shëndetit publik për mungesë të ujit të pijes dhe sfida e fillimit të vitit të ri shkollor,

Në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Drenasit ftohen përgjegjësit e KRU “Prishtina” për të na informuar rreth gjendjes së furnizimit me ujë.

Drenas, më 03.09.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		03/09/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	37769	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas



Për:	Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit
Nga:	Ramiz Lladrovci, kryetar i Komunës së Drenasit
Lënda:	Kërkesë për Seancë të jashtëzakonshme
Datë:	3.9.2026

Në bazë të nenit 44, paragrafi 44.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe dispozitave të Statutit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, ftoj seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës,

I nderuari z. Bujupi, Kryesues i Kuvendit
Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Ju ftoj në Seancë të jashtëzakonshme, të mërkurën, më 9.9.2026, në ora 10:00.

Pika e Rendit të ditës, është:

Rrezikimi i shëndetit publik, në veçanti në shkolla si pasojë e mungesës së tej zgjatur dhe alarmante të furnizimit me ujë të pijshëm si rezultat i mos riparimit të pompave në Bivolak të Vushtrrisë nga ana e KRU “Prishtina” dhe mos funksionalizimi burimeve sekondare të ujit në territorin e komunës së Drenasit (Krajkova, Gjërgjica, Arllati, Kishnareka, Baica, Sankovci, etj.), mos trajtimi i investimeve të Komunës nga KRU “Prishtina” për ujin e pijes në fshatrat e Komunës së Drenasit

Me qëllim të informimit të qytetarëve për çështjen e furnizimit me ujë, kundërshtimit të gjendjes së rënduar, rrezikimi i shëndetit publik për mungesë të ujit të pijes dhe sfida e fillimit të vitit të ri shkollor,

Në Seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Drenasit, ftoj përgjegjësit e KRU “Prishtina”, për të na informuar rreth gjendjes së furnizimit me ujë.

Me nderime,

Arsyetim

Prioriteti i mirëqenies së qytetarëve në Komunën tonë, është uji. Sfidat e furnizimit me ujë, janë të mëdha. Sfida më e madhe është furnizimi me ujë i shkollave dhe institucioneve publike në shërbim të qytetarëve. Ftoj përgjegjësit e KRU “Prishtina”, Drejtorin rajonal të KRU “Prishtina” dhe Shefin lokal të KRU “Prishtina” në Drenas, të na informojnë për gjendjen, perspektivën dhe sfidat e furnizimit me ujë të pijes në komunën e Drenasit.